




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Komuna e Gjakovës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport do të bëjë zgjedhjen e laureatëve të dalluar në sport për vitin 2025.

N J O F T I M

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Gjakovës, njofton të gjitha organizatat e regjistruara si OJQ, Klube, Shoqata Sportive apo individ, që t'i dërgojnë propozimet e tyre për zgjedhjen e sportistëve më të mirë, të cilët duhen të bëhen ekskluzivisht nëpërmjet Klubeve Sportive.

Propozimet bëhen për: **Sportistin, Trajnerin, Klubin, Shpresën e vitit, Punëtorin Sportiv, Referin më të mirë si dhe propozimin për sportistët të cilët kanë kontribuar ndër vite në sport (deri në 3 propozime) dhe për kategorinë Post Mortem (deri në 5 propozime).**

Gjatë propozimit për laureatë, në mënyrë të qartë duhet të përshkruhet aktiviteti i secilit sportist dhe të specifikohet pjesëmarrja në garat ekipore dhe individuale si p.sh. (Diplomat, Medaljet, Certifikatat, Arritjet, fotot, etj) në të cilat kanë garuar sportistët / klubet dhe sukseset të cilat i kanë arritur në nivel kombëtarë dhe ndërkombëtarë gjatë vitit 2025.

Propozimet për zgjedhjen e laureatëve më të mirë mund të bëhen përmes klubeve sportive dhe të dorëzohen fizikisht në Pallatin e Kulturës “Asim Vokshi”, Rr. “UÇK”, p.n. 50 000 Gjakovë, më së largu deri më datën **22.01.2026, ora: 16:00.**

Përzgjedhja e më të mirëve do të bëhet nga Komisioni i themeluar për këtë qëllim.

Bashkangjitur gjeni formularin për aplikim – Lauratët e vitit 2025!

Me respekt!



Udhëheqës i Sektorit të Sportit